4	Sistemi SAN	cope	2			
5	Pajisje Switch Core	cope	2			
6	Sistemi i Backup në Disk	cope	1			
7	Instalimi, konfigurimi dhe testimi	set	1			
8	Asistencë Teknike dhe Garanci	set	1			
<b>Çmimi total (Mallrat)</b>						_____
<b>Çmimi Neto pa TVSH</b>						
<b>TVSH (%)</b>						
<b>Çmimi total me TVSH:</b>						
<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>						
<b>Nënshkrimi</b>						
<b>Vula</b>						
<b>Datë</b> _____						

### Shtojca 3.

[ Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

## FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës se prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

#### Shtojca 4.

(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

#### Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

#### VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkreisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### Përfaqësuesi i Ofertuesit

#### Nënshkrimi

#### Vula



---

## Shtojca 5.

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor ]

### FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

#### 1.1. Përfituesi /Autoriteti Kontraktues

Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a.

#### 1.2. Historiku

Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a është një shoqëri aksionare shtetërore, e krijuar me datë 14/07/2004, si rezultat i reformimit dhe ndarjes së Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare në tre shoqëri të veçanta. OST sh.a. garanton kapacitetet e nevojshme transmetuese për:

1. Furnizimin e pa ndërprerë me energji elektrike të nënstacioneve të sistemit të shpërndarjes dhe konsumatorëve të energjisë elektrike të lidhur direkt në rrjetin e transmetimit;
2. Transmetimin e energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vendit;
3. Tranzitet dhe shkëmbimet e nevojshme me vendet e rajonit;

## 2. OBJEKTIVAT, QËLLIMI DHE REZULTATET E PRITURA

---

#### 2.1. Objektivi i Përgjithshëm

Objektivi i përgjithshëm i projektit është dizenjimi dhe implementimi i infrastrukturës për site backup të sistemit SCADA në OST.

#### 2.2. Qëllimi

OST sh.a. ka vendosur të realizojë implementimin e infrastrukturës teknologjike të sistemeve të SCADA në site backup me qëllim ruajtjen e informacionit dhe përmirësimin e performancës dhe sigurisë.

Zgjidhja e kërkuar duhet të jetë bazuar në produkte të gjeneratës së fundit, protokolle komunikimi të sigurt, të jetë fleksible për zgjerim në të ardhmen dhe sa më praktike gjatë operimit të përditshëm dhe mirëmbajtjes.

Qëllimi i punës përfshin projektimin, ndërtimin, zhvillimin, vënien në punë, komisionimin dhe testimin e pajisjeve të nevojshme për krijimin e infrastrukturës në site backup.

#### 2.3. Objektivat

Qëllimi i këtij angazhimi është të reagojë ndaj nevojave gjithmonë në rritje për kapacitete përpunimi, ruajtje dhe transmetimi të informacionit dhe t'i paraprijë ndryshimeve teknologjike për transformimin e vërtetë të prioriteteve dhe aktiviteteve OST. Gjithashtu, një nga objektivat kryesore të këtij angazhimi është vlerësimi, konceptimi dhe dizenjimi i një infrastrukture moderne, të besueshme, por njëkohësisht efikase dhe elastike në përdorim, për të rritur performancën dhe sigurinë në përpunimin dhe transmetimin e informacioneve kritike.

Për të arritur këtë qëllim, ne i shohim objektivat e mëposhtëm si elementë të rëndësishëm për projektin tonë:

- Përdorimi i një strukture me model zhvillimin e industrisë për të vlerësuar pikat e forta dhe dobësitë e gjendjes aktuale të infrastrukturës TI në të gjitha domainet dhe proceset e

---

teknologjisë. Duhet të identifikojmë dhe vlerësojmë dobësitë kryesore, rreziqet dhe ekspozimin e mundshëm ndaj kërcënimeve kibernetike në infrastrukturën tonë;

- Përcaktimi i një qëllimi të ardhshëm mbi nevojat për kapacitete, performancë dhe besueshmëri, duke përfshirë identifikimin e çdo boshllëku midis gjendjes aktuale dhe asaj të ardhshme që duhet adresuar;
- Hartimi i një liste të rekomandimeve për përmirësimin e prioriteteve të përshtatshme dhe të zbatueshme, që përbëhet nga praktikatat më të mira që adresojnë drejtpërdrejt mangësitë e identifikuarat dhe ndihmon OST-në për të krijuar një plan për të arritur qëllimin tonë të ardhshëm.

Ofertuesi duhet të përgatisë një dokument të detajuar me një dizajn modern për një infrastrukturë me performancë dhe siguri të lartë, si dhe kapacitetet e nevojshme, të cilat duhet të jenë elastike për t'u zgjeruar në çdo kohë sipas nevojës.

Për këtë duhet që dizajni, planifikimi dhe implementimi të bazohet në rekomandimet më të mira të prodhuesve dhe pajisje dhe softuere me karakteristika dhe veçori të gjeneratës më të fundit, me qëllim eliminimin e problemeve të versioneve të vjetra, të cilat ndikojnë negativisht në performancën e sistemeve dhe sigurinë e infrastrukturës.

Dizajni i ri duhet të konsiderojë dhe ofrojë të gjithë komponentët e infrastrukturës, si ambientin virtual dhe storage me performancë të lartë dhe kapacitete të mjaftueshme për të gjitha makinat virtuale, sistemin komunikimi modern bazuar në protokolle të sigurtë dhe sistemin backup me kapacitete të mëdha dhe shpejtësi të lartë për të patur mundësinë e rikthimit në raste të problemeve të ndryshme të sistemeve të veçanta apo gjithë infrastrukturës në rast se do të ishte e nevojshme.

---

## 2.4. Rezultatet që duhet të arrihen nga Kontraktori

Kontraktori duhet të bëjë planin e detajuar, ta zbatojë dhe ta realizojë duke respektuar të gjitha standardet përkatëse të sistemeve të virtualizimit, storage, rrjet komunikimi, backup & rikthim praktikat dhe eksperiencat me të mira të sistemeve energjitike europiane.

Projekti duhet të konsiderohet “Turn Key”, pra me çelsa në dorë. Rezultatet që priten të arrihen nga kontraktori për këtë projekt janë:

- Konceptimi i zgjidhjes së infrastrukturës së site backup të sistemit SCADA. Në këtë infrastrukturë do të hostohen të gjitha makinat virtuale, të cilat shërbejnë për përpunimin dhe ruajtjen e informacionit. Infrastruktura duhet të jetë e gjeneratës më të fundit, që të mundësojë parametrat teknikë për një performancë dhe siguri sa më të lartë, si dhe të jetë për një kohëzgjatje sa më të madhe.
- Implementimi i një infrastrukture virtuale për hostimin e të gjithave makinave virtuale dhe për operim me performancë të lartë. Makinat virtuale në site backup duhet të operojnë pa kryer ndryshime në adresat IP.
- Implementimi i një sistemi storage i gjithi me disqe SSD për performancë dhe besueshmëri maksimale. Kapacitetet e tij duhet të jenë të tilla të ruajnë informacion për një periudhë të gjatë, duke përfshirë edhe kopje (snap shot) të makinave virtuale për rikthim të tyre në një gjendje të mëparshme në rast se do të jetë e nevojshme. Kërkohej të implementohen 2 (dy) sisteme storage; i pari në site primar, për të replikuar në kohë reale me storage ekzistues (IBM FS5015), me qëllim krijimin e një redundance për të mos patur asnjë shkëputje në rast të problemeve më njërin prej pajisjeve dhe i dyti në site backup për të replikuar në nivel pajisje me storage primar.
- Implementimi i një infrastrukture SAN moderne, redundante, me shpejtësi të lartë dhe të sigurt.
- Implementimi i një infrastrukture backup në disk me shpejtësi backup dhe rikthimi të lartë dhe kapacitete të mjaftueshme për ruajtjen e të dhënave për disa vjet.
- Përdorim i protokolleve të komunikimit standard dhe të besueshëm.
- Dizajn modern sipas praktikave më të mira.
- Projektimi i zgjidhjes duke pasur parasysh mundësinë e zgjerimit të tij në të ardhmen.
- Krijimi i infrastrukturës me arkitekturë që të garantojë redundancë të plotë.

## 3. SUPOZIMET DHE RISQET

---

### 3.1. Supozimet e projektit

Faktorët që supozohet se mund të kenë ndikim në ecurinë e projektit janë:

- Bashkëpunimi dhe koordinimi midis stafit të kontraktorit që do të kryejë lëvrimin e projektit dhe stafit përgjegjës të OST.
- Alokimi i burimeve njerëzore të nevojshme për implementimin e këtij projekti nga të dy palët.
- Vënia në dispozicion e infrastrukturës së nevojshme për implementimin e këtij projekti me të gjithë komponentët.
- Supozohet që kontraktori në zgjidhjen e vet teknike të konsiderojë çdo material dhe element pasiv apo aktiv si pjesë e impementimit të projektit.

### 3.2. Risqet

Në risqet që paraqiten për mbarëvajtjen e problemit janë:

- Mos lëvrimi në kohë i projektit dhe mosrespektimi i afateve;

- 
- Ndryshime domethënëse të situatës në funksionimin e infrastrukturës aktuale, të cilat mundet të çenohet gjatë procesit të ndërtimit të infrastrukturës së re TI.
  - Kjo kategori risqesh përfshin mangësitë teknike të personelit, skedulet jo korrekte të implementimit të programeve të ndryshme gjatë konfigurimit, respektimin e buxheteve të alokuara, zhvillimin e funksioneve të gabuara në program, ndërfaqen e gabuar nga përdoruesit etj. Këtu përfshihet dhe zëvendësimi i shpejtë i teknologjisë aktuale mund të sjellë kosto të lartë operationale gjatë implemtimit të projektit.

## 4. QËLLIMI I PUNËS

---

### 4.1. Të Përgjithshme

#### 4.1.1. Përshkrimi i detyrës

Në realizimin e infrastrukturës së site backup të SCADA, Kontraktuesi duhet të përdorë teknologjinë më të përparuar në dispozicion në aspektin e dizajnit dhe të projektimit dhe duhet të ofrojë fleksibilitet maksimal për të mundësuar në të ardhmen zgjerimin dhe përmirësimin e sistemit në fjalë, duke pasur parasysh dinamikën dhe zhvillimin e parashikuar në vitet e ardhshme për sistemin energjetik në Shqipëri.

Pas vënies në punë të sistemit, shtesat dhe përditësimet e nevojshme për të përmbushur kërkesat e reja operative duhet të bëhen të mundura përmes ndryshimeve të vogla apo me shtimin e moduleve lehtësisht të disponueshme në treg.

Projekti duhet të zhvillohet si një i tërë, pasi sistemi duhet të implementohet me të gjithë komponentët e vet, si ambienti i virtualizimit, storage, rrjet komunikimi dhe sistem backup & rikthim.

Pas implementimit dhe konfigurimit të sistemit do të kryhen të gjitha testimet e nevojshme për mirëfunksionimin e infrastrukturës.

Do të kryhet konfigurimi i pajisjeve dhe software të backup dhe do të skedulohen job-et e backup, periodiciteti i kryerjes së tij dhe tipi (full, incremental) në varësi të kriticitetit të sistemeve dhe përcaktimit nga stafi i IT të OST.

Kontraktuesi do të ketë detyrë të bëjë:

- Hartimin e një plani për ndërhyrjen në rrjetin ekzistues dhe në pajisjet aktive ekzistuese të OST, i cili do të paraqitet për aprovim nga OST. Kjo është e nevojshme për të shmangur çdo anomali dhe problem në funksionet ekzistuese nga ndërhyrja në rrjet.
- Planin e detajuar të konfigurimit të infrastrukturës.
- Krijimin e cluster për virtualizimin e infrastrukturës, për të lejuar kalimin e makinave nga hosti në host në mënyrë manuale ose automatike pa ndërprerje të punës.
- Konfigurimin e komunikimit të host-eve me storage me protokoll FC me shpejtësi të lartë. Ambienti i komunikimit FC duhet të jetë redundant dhe të ofrojë kapacitete më të larta se sa është nevoja aktuale, për të lejuar mundësi zgjerimi në të ardhmen.
- Konfigurimi i rrjetit të komunikimit bazuar në protokolle moderne dhe të sigurt. Rrjeti duhet të jetë i tillë që të lejojë ngritjen e makinës virtuale në site backup pa kërkuar ndryshimin e adresës IP, me qëllim shmangien e operacioneve manuale. Rrjeti do të segmentohet me qëllim eliminimin e komunikimeve paralele, si dhe uljen e sipërfaqes së sulmit nga keqdashësit.
- Planin e kryerjes së backup sipas standardit 3-2-1-1-0. Zgjidhja duhet të lejojë kryerjen e backup në disk.
- Implementimin e planit të miratuar nga personat e autorizuar në OST.

Kontraktori duhet të hartojë projektin teknik dhe çdo dokumentacion teknik dhe ta paraqesë në OST për miratim.

Gjithashtu, duhet të paraqitet për miratim në OST çdo pajisje që do të instalohet, ndryshime në konfigurimet ekzistuese apo punim që do të bëhet në kuader të projektit.

#### 4.1.2. Hapësira gjeografike që do të mbulohet

Sistemi do të implementohet në ‘Aparat Qendror’ qendror (Kashar) dhe backup (Fier) të OST.

#### 4.1.3. Siguria e sistemit

Hyrja e fizike e kontraktorit në qendrat e të dhënave, sallat e të dhënave, dhe hapësira e dhomës së rrjetit do të jetë e kufizuar për ata me nevojë operacionale për të hyrë në ato hapësira dhe do kryhet e shoqëruar. Autorizimi u sigurohet personave që kanë nevojë për qasje në zonat e përcaktuara, bazuar në profilin e tyre të punës dhe që kanë marrë një kartë personale të hyrjes. Mjetet e aksesit fizik (p.sh. çelësat, kartat e hyrjes, kodet e hyrjes) do të shpërndahen në një mënyrë të kontrolluar në mënyrë që në çdo moment të kohës, të mund të merret një listë e plotë e individëve të emëruar që kanë qasje fizike. Aksesit në sistemet më kritike bazuar në vlerësimin e kriticitetit do të jepet përkohësisht vetëm nëse natyra e nevojës së biznesit për një person është gjithashtu e përkohshme (p.sh. për punën e lidhur me projektin). Proceset e punës për të përcaktuar natyrën e hyrjes së kërkuar do të vendosen në përputhje me të gjitha departamentet e përfshira.

Disponueshmëria	Integriteti	Konfidencialiteti	Niveli i Sigurisë
<input checked="" type="checkbox"/> D3	<input checked="" type="checkbox"/> I3		<input checked="" type="checkbox"/> L

Niveli i sigurisë është i lartë (L), nëse disponueshmëria e të dhënave është D3 ose integriteti i të dhënave është I3.

Kjo procedurë i referohet pikës A 11 të sistemit të menaxhimit të sigurisë së informacionit ISO 27001:2013.

## 4.2. Detyrat specifike

Infrastruktura duhet të sigurojë disponueshmëri dhe performancë të lartë për përpunimin dhe transmetimin e të dhënave për të mbështetur aktivitetet dhe kontrollin, me një nivel të lartë të besueshmërisë. Kontraktori duhet të kryejë një vëzhgim në site “site survey”, në mënyrë që të njohë dhe të evidentojë pajisjet dhe mënyrën e ndërtimit të infrastrukturës.

Detyrat specifike të kontraktorit për realizimin e projektit të rrjetit të komunikimit duhet të fokusohen në realizimin e këtyre pikave:

- Konfigurimi dhe implementimi i pajisjeve të reja servera, storage, switche SAN, switche rrjeti (Core), backup në disk dhe komponentëve të tjerë të nevojshëm për implementimin me sukses të projektit.
- Krijimi i ambientit virtual dhe konfigurimi i tij për të lejuar hostimin e të gjitha makinave virtuale të infrastrukturës SCADA, kalimin e tyre nga një host në tjetrin pa ndërprerje të punës si dhe shfrytëzim sa më optimal të infrastrukturës fizike. Ambienti i ri virtual duhet të komunikojë dhe replikojë me infrastrukturën virtuale ekzistuese (VMware) të SCADA në site primar.
- Konfigurimi i 2 (dy) sistemeve storage; i pari në site primar, për të replikuar në kohë reale me storage ekzistues (IBM FS5015), me qëllim krijimin e një redundance për të mos patur

---

asnjë shkëputje në rast të problemeve më njërin prej pajisjeve dhe i dyti në site backup për të replikuar në nivel pajisje me storage primar.

- Konfigurimi i sistemit SAN Switch duhet të jetë redundant, për të krijuar komunikim të pandërprerë me pajisjet Storage dhe Backup në disk.
- Konfigurimi i rrjetit duhet të lejojë ngritjen e makinave virtuale në site backup pa patur nevojën e ndryshimit të adresave IP, si dhe të jetë i segmentuar në nënrrjeta për të lejuar vetëm komunikimet e nevojshme.
- Sistemi backup në disk duhet të ofrojë shpejtësi gjatë kryerjes së backup apo rikthimit, të ofrojë veçori si kompresimi i të dhënave, të shmangë dublikimin e informacioneve, për të mos konsumuar hapësirë, si dhe të ketë kapacitetet e nevojshme për të ruajtur për një kohë të gjatë informacionin e ruajtur. Ky sistem duhet të ketë mundësi të replikojë me sistemin ekzistues (backup në disk) (StoreOnce) që është implementuar në site primar.
- Dështimi i një komponenti të vetëm ose mungesa e një lidhje nuk duhet të çënojë funksionimin e rrjetit në tërësi ose të asaj pjese të rrjetit. Rrjeti duhet të jetë redundant.
- Projektimin e rrjetit duke pasur parasysh mundësinë e zgjerimit të tij në të ardhmen.
- Të përdoren protokolle komunikimi të përparuar dhe të sigurtë.

Pajisjet dhe modulet shtesë do të jenë në përputhje me karakteristikat e infrastrukturës ku do të instalohen si dhe me funksionet e nevojshme për transmetimin e të dhënave.

Kontraktori duhet të parashikojë të gjitha pajisjet dhe modulet shtesë për upgrade të infrastrukturës së nevojshme për sistemin edhe pse nuk janë të përmendura në mënyrë specifike në dokumentacionin e projektit.

Informacion më i detajuar për konfigurimet aktuale të rrjetit do i jepet Kontraktorit në një moment tjetër, për të dizenuar topologjinë e zgjidhjes.

### **Testimi dhe dokumentacioni përfundimtar**

Në përfundim të projektit do të kryhet testim final i të gjithë sistemit. Kontraktori duhet të parashikojë të gjitha pajisjet dhe aparatet testuese të nevojshme dhe të gjitha testimet do të jenë në ngarkim të tij. Kontraktori në përfundim të projektit duhet të dorëzojë të gjithë dokumentacionin përfundimtar, në të cilin duhet të jenë:

- Projekti i zbatimit (përfundimtar)
- Specifikimet e produkteve
- Konfigurimet përfundimtare të pajisjeve
- Çertifikatat e pajisjeve
- Lista e pajisjeve dhe materialeve të furnizuara

---

## **5. LOGJISTIKA DHE KOHA**

### **5.1. Vendndodhja**

Zyrat qendrore të OST sh.a. Kashar, Tiranë dhe site backup (DR) në Fier.

### **5.2. Data e Fillimit dhe Periudha e Implementimit të Detyrave**

Data e caktuar e fillimit është menjëherë pas lidhjes së kontratës dhe periudha e zbatimit të kontratës do të jetë 4 (katër) muaj nisur nga kjo datë.

---

## **6. RAPORTIMI**

---

## 6.1. Kërkesat e Raportimit

Kontraktuesi do të paraqesë raportet e mëposhtme në shqip në origjinal dhe në 3 (tre) kopje:

- **Raporti Fillestar** prej maksimumi tre faqesh duhet të prodhohet brenda një (1) jave, nga fillimi i implementimit. Në raport Kontraktuesi duhet të përshkruajë gjetjet fillestare, progresin në mbledhjen e të dhënave, çdo vështirësi të pritura ose të hasura përveç programit të punës apo udhëtimeve të stafit. Kontraktuesi duhet të vazhdojë me punën e tij derisa Autoriteti Kontraktues të dërgojë komente mbi raportin fillestar.
- **Drafti i raportit përfundimtar** duhet të përbëhet prej maksimumi 10 faqesh. Ky raport duhet të dorëzohet 15 ditë para përfundimit të periudhës së zbatimit të detyrave.
- **Raporti final** me të njëjtat specifika si drafti i raportit përfundimtar, me përfshirjen e komenteve të pranuar nga palët në draft raport. Afati i fundit për dërgimin e raportit përfundimtar është 10 ditë pas marrjes së komenteve në draft raportin përfundimtar.

Raporti duhet të përmbajë një përshkrim të mjaftueshëm të detajuar të opsioneve të ndryshme. Analizat e detajuara që i mbështesin rekomandimet do të prezantohen në anekset në raportin kryesor. Raporti përfundimtar duhet të sigurohet së bashku me faturën përkatëse.

Informacion tjetër i rëndësishëm për raportet.

- 1- Raport instalimi.
- 2- Raport i arkitekturës HW, SW i sistemit.
- 3- Inventari (HW, SW, etj).

## 6.2. Dorëzimi dhe Miratimi i Raporteve

Raporti i përmendur më sipër duhet t'i dorëzohet personit përgjegjës i cili do të administrojë Kontratën. Ky person është përgjegjës për aprovimin e raporteve.

---

## 7. KOMUNIKIMI ME SISTEME TË TJERA

Diagramat dhe informacionet e nevojshme për komunikimin me sistemet e tjera do i vihen në dispozicion Kontraktorit në momentin e duhur.

---

## 8. GARANCIA

Periudha e garancisë së sistemit që do të implemetohet do të jetë 12 muaj.

---

## 9. MIRËMBAJTJA

Marrëveshja e shërbimit të mirëmbajtjes së sistemit do të jetë për një periudhë 1 (një) vjeçare në përputhje me dispozitat e VKM-së Nr. 710, datë 21 gusht 2013, "Për Krijimin dhe Funkcionimin e Sistemeve të Ruajtjes së Informacionit, Vazhdueshmërisë së Punës dhe Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit".

### Shërbimet e Mirëmbajtjes

Kompania duhet të ofrojë shërbime të mirëmbajtjes sipas kërkesës së përshkruar më poshtë:

- Shërbime të mirëmbajtjes parandaluese. Operatori ekonomik duhet të ndërmarrë, në mënyrë periodike një herë në tre (3) muaj, Shërbime të Mirëmbajtjes Parandaluese për të gjitha software-et dhe hardware-et. Shërbimet Parandaluese janë shërbime proaktive të cilat do të

mundësojnë detektimin në kohë të problematikave, dhe do mundësojnë ndërmarrjen në kohë të hapave rekuperuese, për të mos patur ndërprerje të shërbimit.

- Shërbime Riparimi në vendndodhje (mjediset e autoritetit kontraktor/përfituesit) Operatori ekonomik duhet të jetë i disponueshëm gjatë intervalit kohor, nga e Hëna në të Premte, 8x5, për të ofruar Shërbime të Riparimit në përgjigje të “Alarmeve Madhore” të raportuara nga personeli i autorizuar (“Emergency On-Call Hours”). Për këtë qëllim, me termin Alarm Madhor do të kuptohet parashtrimi i kërkesës për Shërbime Riparimi të ndërmarra në rast të keqfunksionimit të softwareve apo hardware të mbuluara, që i pengon ato të operojnë në përputhje me specifikimet dhe shkaktojnë ndërprerje të sistemit.

(i) Njoftimi dhe Njohja e Alarmeve Madhore. Personat përgjegjës do të njoftojë operatorin ekonomik me telefon, postë elektronike ose duke sinjalizuar nëpërmjet ndonjë ndërfaqeje web të vënë në dispozicion, dhe do të presë të kontaktohet nga operatori ekonomik me telefon, gjatë “Emergency On-Call Hours”. Operatori ekonomik duhet të kontaktojë personelin përgjegjës dhe të konfirmojnë marrjen e Alarmit Madhor brenda 60 minutave nga marrja e njoftimit nga personeli i autorizuar.

(ii) Përgjigja ndaj Alarmeve Madhore. Nëse operatori ekonomik nuk mund të përcaktojë shkakun e defektit nga komunikimi me personelin e autorizuar, atëherë ai duhet të dërgojë një Teknik Shërbimi pranë Zyrave Qendrore të Autoritetit Kontraktor/Përfituesit brenda intervalit kohor prej (4) katër orësh nga momenti i marrjes së njoftimit për Alarm Madhor. Me të mbërritur, tekniku i kompanisë do të mbështetet me asistencë nga personeli i autorizuar dhe do t’i jepet liri veprimi në mjediset dhe sistemet e mbuluara, i shoqëruar dhe survejuar nga personeli i autorizuar, për të filluar menjëherë procedurat e diagnostikimit dhe riparimit.

Operatori ekonomik fitues duhet të dokumentojë çdo veprim, duke paraqitur gjendjen para dhe pas ndërhyrjeve si dhe duhet të marrë aprovimin paraprak për çdo ndërhyrje.

Palët e përfshira duhet të krijojnë një agjendë periodike kontrollesh (të cilat kur është e mundur mund të kryhen dhe nga distanca (remote)). Kontrollat janë si më poshtë:

### 3 (Tre) Mujore.

- a. Testim/kontroll i kompletuar i pjesëve më kritike të infrastrukturës.
- b. Kontroll i detajuar i log-eve hardware/software.
- c. Rekomandime për upgrade të mundshme hardware/software.
- d. Kontroll i funksionaliteteve të sistemit.

## 10.PLANIFIKIMI I BUXHETIT PËR NDËRTIMIN E SISTEMIT

Nr.	Emërtimi	Sasia	Njesia
1	Projekti teknik dhe Inxhinierik	1	set
2	Servera dhe licensa per ambientin virtual	3	cope
3	Pajisje Storage	2	cope
4	Sistemi SAN	2	cope
5	Pajisje Switch Core	2	cope



6	Sistemi i Backup ne Disk	1	cope
7	Instalimi, konfigurimi dhe testimi	1	set
8	Asistence Teknike dhe Garanci	1	set

## 11.AFATI KOHOR I REALIZIMIT TË PROJEKTIT

Projekti duhet të marrë përsipër ndarjen në faza të implementimit si më poshtë:

**Faza e planifikimit dhe dizajnit (2 javë).** Gjatë kësaj periudhe, duhet të detajohet dhe përcaktohet me saktësi skema dhe arkitektura e zgjidhjes së propozuar, për të qenë sa më e përshtatur me nevojat aktuale, si dhe të shërbejë si hallkë e rëndësishme drejt implementimit të produkteve dhe teknologjive të reja që do konsistojnë në rritjen dhe përmirësimin e sigurisë dhe performancës së rrjetit të OST. Kjo do të kryhet në bazë të një (ose më shumë) mbledhje (takim pune), dhe do të konkludojë me përpilimin e një skeme për krijimin e zgjidhjeve të rrjetit që do të implementohen. Duke u bazuar në këto raporte dhe arkitekturën e përmendur, duhet të hartohet një plan për shërbimet e implementimit. Plani duhet të hartohet konform gjithë standardeve industriale/teknike në këtë fushë të teknologjisë. Modeli i mësipërm do të ndiqet në mënyrë që të arrihet një rezultat i kënaqshëm i implementimit të përmirësimit të infrastrukturës si nga ana e performancës ashtu edhe nga ana e sigurisë.

**Fazë implementimi (4 muaj).** Gjatë kësaj faze duhet të fillojë zbatimi i planit të implementimit që është detajuar në fazën e planifikimit. Në këtë projekt do të punohet duke implementuar sipas rradhës:

- **Levrimi dhe konfigurimi i pajisjeve servera.** Pajisjet e reja duhet të instalohen në datacenter backup (DR) e OST në Fier. Këto pajisje do të krijojnë ambientin për të kryer funksionet që aktualisht kryhen në ambientin virtual në site primar të SCADA dhe gjithashtu do të konfigurohen me protokollet, metodologjitë dhe politikat e sigurisë më të përshtatshme për të ofruar të gjithë funksionet, performancën dhe sigurinë shtesë që ka nevojë OST. Gjatë operacioneve që do të kërkojnë ndërhyrje në sistemet ekzistuese, implementimi do të kryhet në periudha kohore që nuk afektojnë punën e sistemeve të SCADA, në bashkëpunim me IT dhe departamentet e tjerë.
- **Konfigurimi i ambientit të virtualizimit.** Sistemi i virtualizimit duhet të jetë i licencuar për të gjithë core-t e procesorëve të serverave të ofruar. Gjithashtu platforma duhet të ofrojë menaxhim të centralizuar të infrastrukturës virtuale. Konfigurimi i infrastrukturës virtuale duhet t'i lejojë administratorët e TI-së të garantojnë sigurinë dhe disponueshmërinë, t'u thjeshtojë detyrat e përditshme dhe të zvogëlojë kompleksitetin e menaxhimit të infrastrukturës virtuale. Në rast të nevojave për të kaluar shërbimet në site backup (DR) platforma duhet të menaxhohet pa patur nevojë për instalime apo konfigurime shtesë.
- **Konfigurimi i pajisjeve SAN.** Sistemi SAN në site backup (DR) do të konfigurohet me dy pajisje SAN Switch redundante për lidhjen e gjithë komponentëve të infrastukturës: ambienti virtual, storage, backup në disk.
- **Konfigurimi i pajisjes storage.** Pajisja storage do të ofrohet më disqe SSD dhe duhet të konfigurohet për të ofruar performancë dhe besueshmëri maksimale. Komunikimi i storage me hostet e cluster do të konfigurohet me protokoll FC me shpejtësi të lartë. Volumet do të krijohen bazuar në rekomandimet e prodhuesit dhe nevojat e OST. Një prej pajisjeve storage do të instalohet në site primar dhe do të konfigurohet si pajisja primare për infrastrukturën e SCADA. Pajisja ekzistuese do të kalojë si pajisje e dytë (redundante), po në site primar dhe do të konfigurohet e tillë që të mos krijojë asnjë shkëputje në rast të ndonjë problemi të

---

pajisjes kryesore. Pajisja storage e dytë do të instalohet në site backup (DR) dhe do të konfigurohet që të replikojë në nivel pajisje më storage të site primar.

- **Konfigurimi i sistemit backup.** Pajisja do të instalohen në godinën e OST, përkatësisht në datacenter e SCADA. Sistemi do të konfigurohet për të kryer backup të sistemeve në disk, sipas përcaktimit nga stafi IT i OST. Periodiciteti dhe lloji i backup do të vendoset së bashku me grupin e punës. Pajisja ekzistuese e backup në disk do të konfigurohet në site backup (DR) në Fier.

Etiketimi i pajisjeve do të kryhet në bazë të etiketimit ekzistues, ose në rast të kundërt duhet të krijohet një mënyrë etiketimi që do ndihmojë administratorët në riparimet dhe shërbimet e nevojshme si dhe familjarizimin e tij me infrastrukturën e krijuar.

Grafiku i lëvrimit të shërbimit mbas lidhjes së kontratës me Autoritetin kontraktor.

Nr.	Emërtimi i fazës / Periudha kohore	M1	M2	M3	M4	M5 – M16
1	Projekti teknik dhe Inxhinierik	X				
2	Pajisje dhe licenca	X	X			
3	Instalimi dhe konfigurimi		X	X	X	
4	Komisionimi dhe testimi			X	X	
5	Garancia	X	X	X	X	X

## 12. KËRKESAT TEKNIKE DHE FUNKSIONALE

---

### Funksionalitete

Arkitektura e re që do të propozohet duhet të sigurojë një strukturë të aftë për të ofruar shërbimin me cilësi të lartë në një kontekst të besueshëm, ku dështimi apo mungesa e një elementi të vetëm nuk do të shkaktojë ndonjë ndërprerje të komunikimit. Kontraktori ka përgjegjësinë e plotë për planifikimin e procesit të implementimit dhe handover të shërbimit, për ndryshimet në infrastrukturën ekzistuese dhe në atë të re, duke garantuar mbajtjen e komunikimit të të dhënave në punë.

### Topologjia e kërkuar

Topologjia e re duhet të përfshijë pajisjet Servers, sistem virtualizimi, Storage dhe sistemi i backup & rikthim (restore) të konfiguruar sipas rekomandimeve të prodhuesit, standardeve më të mira dhe sipas kërkesave të OST. Konfigurimet duhet të jenë fleksibël për t'u modifikuar dhe zgjeruar në të ardhmen në varësi të nevojave. Konfigurimet duhet të jenë të tilla që të arrijnë performancë dhe siguri maksimale në përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave.

Ndërhyrjet në infrastrukturën ekzistuese dhe implementimi i infrastrukturës së re në site backup (DR) duhet të kryhet pa ndërprerje të shërbimit, ose në pamundësi të kësaj, me ndërprerje sa më minimale

## 13. SPECIFIKIMET TEKNIKE

---

Specifikimet teknike të hollësishme të infrastrukturës dhe sistemeve ekzistues do t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik fitues që do të implementojë ndryshimet e infrastrukturës ekzistuese dhe konfigurimet në site backup.

### 13.1. Servera Sasia: 3 (tre) copë

<b>Karakteristika minimale teknike</b>	
Formati	Server i montueshëm në kabinet (rack) 2U. Aksesorët e montimit të përfshirë. Krahu për manaxhimin e kabllave i përfshirë.
Procesorët	Serveri duhet të ofrohet me Min. 1 (një) procesor multi-core i gjeneratës së fundit, me min. 32 core 2.1GHz.
Memorie (RAM)	Serveri duhet të përfshijë të paktën 512 GB DDR5-5600 ECC. Memoria duhet të jetë e zgjerueshme deri të paktën 8TB.
Kontrolleri RAID	Serveri duhet të jetë i pajisur me kontrollor RAID SAS 12Gb me 4GB Cache të dedikuar dhe të mbrojtur me bateri ose mënyrë tjetër. Kontrolleri duhet të suportojë mbrojtje Hardware RAID 0, 1, 5, 6, 10. Kontrolleri duhet të suportojë disqe SATA, SAS, etj.
Storage i brendshëm	2 HDD "hot pluggable" min. 480GB SSD, 2.5" Mixed Use të përfshira. Serveri duhet të suportojë deri në minimumi 8 HDD/SSD.
Dalje Ethernet	4 dalje 1Gbps dhe 1 portë dalje e dedikuar për manaxhimin.
Lidhja FC me Storage	2 dalje FC 32Gbps.
Ushqimi	Redundant, "hot pluggable" .
Sistemet e Shfrytëzimit dhe Virtualizimit	Serveri duhet të suportojë sistemet Microsoft Windows Server dhe Microsoft Hyper-V Server, VMware dhe Linux.
Garancia	Minimumi 1 vit, ofruar nga Prodhuesi

### 13.2. Sistem Storage FC Sasia: 2 (dy) copë

<b>Sistemi Storage</b>	
Formati	I montueshëm në kabinet (rack). Aksesorët e montimit të përfshirë.
Pa SPOF (Single Point of Failure)	Sistemi Storage nuk duhet të ketë asnjë komponent SPOF (single point of failure). Të gjithë komponentët duhet të jenë redundant-ë, përfshirë controller-ët (të paktën dy), memorien e kontrollerve, blloqet e ushqimit (të paktën dy), ventilimin, etj.

<b>Sistemi Storage</b>	
Arkitektura	Controller-ët duhet të jenë plotësisht aktive-aktive.
Memoria Cache	Sistemi Storage duhet të ofrojë minimumi 32 GB memorie për controller.
Lidhja e host-eve	Sistemi Storage duhet të ofrojë minimumi 8 (tetë) dalje FC 16 Gbps (katër për controller) për lidhje me host-et. Sistemi Storage duhet të ofrojë minimumi 4 (katër) dalje ETHERNET 10 Gbps (dy për controller).
Disqet dhe mbrojtja RAID	Sistemi Storage duhet të pranojë vetëm disqe SSD. Sistemi Storage duhet të ofrojë mbrojtje RAID 1, 5 dhe 6.
Kapaciteti dhe zgjerimi	Sistemi Storage duhet të ofrohet me të paktën 90 TB kapacitet (RAW) duke përdorur jo më shumë se 12 disqe SSD. Sistemi Storage duhet të pranojë zgjerim deri në të paktën 400 disqe.
Mirëmbajtja	Sistemi Storage duhet të pranojë upgrade të firmware-it online, pa rënie të shërbimeve për të dy controller-ët dhe disqet.
Konfigurimi / menaxhimi	Sistemi Storage duhet të ofrojë ndërfaqe GUI dhe CLI për konfigurimin dhe manaxhimin. Ndërfaqja e manaxhimit duhet të ofrojë monitorim të performancës në kohë reale.
Funksionalitete të përfshira	Sistemi Storage duhet të përfshijë licencë për “Thin Provisioning”, Compression, Deduplication dhe Replikim. Sistemi Storage duhet të ofrojë mundësinë e kriptimit. Sistemi Storage duhet të replikojë me sistemin storage ekzistues (IBM FS5015). Sistemi Storage duhet të ofrojë mundësinë e konfigurimit në cluster. Sistemi Storage duhet të ofrojë mundësinë për replikim në konfigurim me 3-site.
Garancia	Minimumi 1 vit, ofruar nga prodhuesi.

### 13.3. SAN Switch

**Sasia: 2 (dy)**

<b>SAN Switch</b>	
Formati	Rack mounted, 1 rack unit, aksesorët e përfshirë
Porta/Ndërfaqet	12 porta 16 Gbps (licencat, konektorët FC dhe kabllot të përfshira)

	<p>1 portë RS-232</p> <p>1 portë e dedikuar menaxhimi 10/100/1000</p> <p>Përdorim i portave 10/100 Mbps ose i konsolës për menaxhim CLI (me SSHv2)</p>
Menaxhimi	<p>Menaxhim In-band:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Telnet</li> <li>- Secure Shell (SSHv2)</li> <li>- RADIUS, TACACS+</li> <li>- SNMPv3</li> <li>- Diagnostikim POST dhe embedded online/offline që përfshin FC Ping, Pathinfo (FCTraceroute), FC Debug.</li> </ul>
Energjia	<p>Hyrje AC 100 - 240 VAC</p> <p>Frekuenca 50 - 60 HZ</p>
Karakteristikat e operimit	<p>Temperatura operimit: 0 - 40 grade [Celcius] Lagështira : 10% - 90% [e pakondesuar]</p>
Garancia	<p>Minimumi 1 vit, ofruar nga Prodhuesi.</p>

#### 13.4. Backup në Disk (Disc-to-Disc)                      1 (një) copë

<b>Backup në Disk</b>	
Formati	I montueshëm në kabinet (rack) në format min. 2U. Aksesorët e montimit dhe kabllot e nevojshëm të përfshirë.
Kapaciteti i përdorshëm	56 TB i zgjerueshëm deri në 200 TB.
Performanca e shkrimit	25 TB/hr
Funksionalitete të përfshira	Sistemi duhet të përfshijë kompresim, deduplikim, enkriptim, etj.
Lidhja FC me Storage	2 dalje FC me shpejtësi 32Gbps për lidhje me ambientin Storage.
Ushqimi dhe ftohja	Min. 2 (dy) blloqe redundante ushqimi dhe ftohje.

	Bloqet e ushqimit duhet të jenë “hot pluggable”.
Garancia	Minimumi 1 vit, ofruar nga Prodhuesi.

### 13.5. Platformë virtualizimi

Platformë Virtualizimi	
Funksionalitete të përfshira	<p>Duhet të sigurojë një shtresë virtualizimi që vendoset drejtpërdrejt në harduerin fizik.</p> <p>Duhet të lejojë mbështetje për sistemet operative si Windows, Linux, etj.</p> <p>Duhet të ofroj mbështetje për datastoret VMFS.</p> <p>Duhet të ofrojë disponueshmëri dhe replikim.</p> <p>Duhet të ketë aftësinë për të lëvizur makinat virtuale që funksionojnë nga një host në tjetrin pa ndërprerje, për të siguruar vazhdimësinë e biznesit.</p> <p>Duhet të ofrojë mbështetje për tokologjinë Thin Provision për makinat virtuale</p> <p>Të lejojë hostet fizike të lidhen me një sistem menaxhimi të centralizuar për t'i administruar dhe krijuar makina virtuale.</p> <p>Të mundësojë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- monitorim të gjendjes dhe analizë të performancës;</li> <li>- manaxhim dhe optimizimi të kapaciteteve;</li> <li>- paneli të operacioneve dhe analizë të situatave;</li> <li>- hipervizor (hypervisor);</li> <li>- zhvendosje të makinave virtuale;</li> </ul> <p>Të komunikojë dhe replikojë me infrastrukturën virtuale ekzistuese.</p>
Licencimi dhe Garancia	Licencat e ofruara duhet të mbulojnë të gjitha coret e infrastrukturës ku do të implementimet dhe të kenë suport për të paktën 1 vit.

### 13.6. Switch Core L3

2 (dy) copë

Switch Multi Layer	
Forma fizike	Rack mounted, 1 rack unit, thellësia jo me shume se 40 cm, aksesoret e përfshire.
Porta/Ndërfaqet	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Minimumi 24 porta RJ45 (10/100/1000 Base-T);</li> <li>• 4 porta 10Gb që suportojnë transceivera SFP/SFP+;</li> <li>• Të paktën 8 porta me support për MACsec;</li> <li>• 1 portë menaxhimi RJ-45;</li> <li>• 1 portë USB 2.0;</li> <li>• 1 portë Console (RJ-45 ose USB);</li> <li>• 1 slot i lirë për modul opsional për shtim portash 10/40 Gbps (moduli nuk kërkohet të jetë i përfshirë në këtë fazë);</li> <li>• Kabllo stakimi të përfshire;</li> </ul>
Memoria	<ul style="list-style-type: none"> <li>• 512 MB flash;</li> <li>• 2 GB SDRAM;</li> <li>• Madhësia e Packet buffer: 4 MB;</li> </ul>

<b>Throughput/Performanca</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Arkitektura non-blocking, të ofrojë switchim wire-speed;</li> <li>• 180 Mpps throughput;</li> <li>• Kapacitet për Switchim/Rutim: 280 Gbps;</li> <li>• Tabela e rutimit: 32K (IPv4), 16K (IPv6);</li> <li>• Tabela e adresave MAC: 32K;</li> <li>• Vonesa me e vogël se 5 μs në portat 1 ose 10 Gbps;</li> <li>• Lista kontroll aksesi: ACL në 3K hyrëse (ingress) dhe 1K dalje (egress);</li> </ul>
<b>Power</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Hapësirë për 2 blloqe ushqimi;</li> <li>• Të jetë i pajisur me një bllok ushqimi AC 220V 50Hz;</li> </ul>
<b>Disponueshmeria</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Teknologji stacking dhe virtualizim duke bashkuar deri në tetë pajisje në një stack duke lejuar menaxhimin dhe konfigurimin si një pajisje e vetme që lehtëson implementimin dhe mirëmbajtjen;</li> <li>• In service software upgrade;</li> <li>• Teknologji të avancuara nga ku të përfshihen standardet e industrisë për OAM, BFD, ECMP, VRRP;</li> </ul>
<b>Karakteristikat e shtresës L2</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Implementimi i standardit IEEE 802.1Q VLAN, 4094 ID;</li> <li>• Standardi IEEE 802.1ad QinQ ;</li> <li>• Bashkim portash 10GbE që lejon grupimin dhe shfrytëzimin me të mirë të linjave për të rritur sasinë e transmetimit;</li> <li>• Link Aggregation Control Protocol (LACP - IEEE 802.3ad);</li> <li>• Spanning Tree - MSTP, RSTP;</li> <li>• Minimumi 50 Instanca MSTP;</li> <li>• Kontroll mbi trafikun Multicast me anë të protokolleve Internet Group Management Protocol (IGMP v1,v2,v3) dhe Multicast Listener Discovery (MLD) snooping;</li> <li>• Voice VLAN, Multicast VLAN;</li> <li>• LLDP, LLDP-MED;</li> </ul>
<b>Karakteristikat e shtresës L3</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Switchim dhe ACL me shpejtësi wire (media);</li> <li>• Suport për rutim në IPv4 sipas standardeve: Static routing, RIP, OSPF dhe BGP;</li> <li>• Suport për rutim në IPv6 sipas standardeve: Static routing, RIPng, OSPFv3 dhe BGP4+;</li> <li>• Te ofroje ndërfaqe Loopback të adresueshme;</li> <li>• Standardet për tunelime të IPv6 mbi IPv4;</li> <li>• Rutim në Multicast (IPv4, IPv6): PIM-SM, PIM-DM, PIM-SSM;</li> <li>• Address Resolution Protocol (ARP): static, ARP proxy, Gratuitous ARP për detektimin e adresave IP të duplikuara;</li> <li>• DHCP Server, Relay;</li> <li>• Tunelime GRE për VPN që mundëson tunelime të Layer2 mbi Layer3;</li> </ul>
<b>Karakteristika të avancuara për rrjetin</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Te ofroje MPLS me MPLS VPN dhe MPLS TE;</li> <li>• Virtual Private LAN Service (VPLS);</li> <li>• Equal-Cost Multipath (ECMP);</li> <li>• Rutim Policy-based;</li> <li>• Route maps për kontroll me të mirë në shpërndarjen e rutimeve;</li> </ul>
<b>Siguria</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Lista kontroll aksesi (ACLs) që suportojnë filtrime trafiku duke u bazuar në informacionet nga shtresa L2 deri në L4;</li> <li>• Suport për ACL globale, në VLAN dhe në porte;</li> <li>• ACL në hardware me TCAM;</li> <li>• IEEE 802.1X sipas standardeve të industrisë në bashkëpunim me Radius Server;</li> <li>• Menaxhim me SSHv2, HTTPS, SNMPv3 dhe me server qendror të tipit RADIUS dhe TACACS;</li> <li>• Autentikim bazuar në adresat MAC me Radius Server;</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kontroll aksesi bazuar ne identitetin e përdoruesit duke aplikuar ACL specifike ose VLAN ne nivel përdoruesi;</li> <li>• Port security, Port isolation, IP/IPv6 source guard;</li> <li>• Mbrojte nga ARP attack me Dynamic ARP dhe DHCP/DHCPv6 snooping;</li> <li>• Unicast Reverse Path Forwarding;</li> </ul>
<b>QoS</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mundësi për klasifikimin e trafikut bazuar ne: ACLs (access control lists), përparësitë e diktura nga IEEE 802.1p dhe DSCP/Type of Service (ToS);</li> <li>• Te suportoj funksionet: remark, redirect, mirror dhe filter;</li> <li>• Te suportojte standarde: SP (Strict Priority Queuing), WFQ (Weighted Fair Queuing), WRED (Weighted Random Early Detection), WDRR (Weighted Deficit Round Robin);</li> <li>• Te ofroje limitim te trafikut te tipit storm nga Broadcast, Multicast dhe Unicast te panjohur;</li> </ul>
<b>Menaxhimi</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Konfigurim ne distance ne CLI me SSH, VLAN menaxhimi, ruajtje logesh;</li> <li>• Mundësi për te pasur 2 imazhe te sistemit te operimit, një primar dhe një sekondar (për backup);</li> <li>• Ruan ne disa versione filete e konfigurimit qe lejon kthimin e pajisjes ne një gjendje te caktuara;</li> <li>• Port mirroring dhe aftësi për te përzgjedhur ne baze ACL trafikun hyrës/dalës nga një porte ose VLAN dhe te pasqyroje atë ne një porte lokale ose remote.</li> <li>• SNMP v1, v2c and v3; NTPv3;</li> </ul>
<b>Licencimi</b>	Pajisja Switch do te jete e licencuar për te gjitha karakteristikat dhe kapacitetet me sipër.
<b>Karakteristikat mjedisore</b>	Temperatura e operimit: 0 – 45 grade Celsius Lagështira relative e operimit: 15% to 90%, pa kondensim
<b>Garancia</b>	1 vit suport nga prodhuesi me dërgim te pajisjes ne ditën vijuese te punës (NBD) si dhe përditësimet e softuerit te përfshira

**Shënime:**

- i. Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.
- ii. Kudo ne Specifikimet Teknike ku jane cituar standarde nderkombetare, do te pranohen edhe cilësime ekuivalente nga një institut vendor.



## Shtojca 6

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)*

### FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

#### Sasia e mallit që kërkohet:

Nr.	Përshkrimi i mallit	Njësia	Sasia
1	Projekti teknik dhe Inxhinierik	set	1
2	Servera dhe licensa për ambientin virtual	cope	3
3	Pajisje Storage	cope	2
4	Sistemi SAN	cope	2
5	Pajisje Switch Core	cope	2
6	Sistemi i Backup në Disk	cope	1
7	Instalimi, konfigurimi dhe testimi	set	1
8	Asistencë Teknike dhe Garanci	set	1

#### Afatet e lëvrimit:

16 (gjashtembedhjete) muaj nga hyrja në fuqi e kontratës, sipas përcaktimeve të bëra në Specifikimet Teknike.

Artikulli	Përshkrimi	Shuma	Destinacioni	Periudha e dorëzimit
-----------	------------	-------	--------------	----------------------

1	DRS site dhe zgjerimi i platformës teknologjike të SCADA		OST sh.a.	16 (gjashtembedhjete) muaj nga hyrja ne fuqi e kontratës, sipas përcaktimeve te bëra ne Specifikimet Teknike.
---	--	--	-----------	---

## Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

### FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

#### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, oseqë ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale; dh nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët

---

janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

### **Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

